

**VENDIM**  
**Nr. 513, datë 1.7.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 893, DATË 4.11.2015,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN  
E INSPEKTORATIT KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar; të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtesa “Ministria e Punëve të Brendshme” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ...” dhe fjala “... Dega ...” zëvendësohet me fjalët “... Drejtoria Rajonale ...”.

2. Në kreun I bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është institucion qendror, buxhetor, person juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe të ndërtimeve, si dhe për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e peizazhit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji, me seli në Tiranë.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Misioni i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit është kontrolli, mbrojtja e territorit dhe e peizazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, të planifikimit, të mbrojtjes së territorit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve, të disiplinimit të punimeve në ndërtim, të produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.”.

3. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, me këtë përmbajtje:

f) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Berat;

g) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Dibër;

gj) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Elbasan;

h) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Fier;

i) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Lezhë.”.

b) Në pikën 4, fjalët “... në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, ‘Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme’, të ndryshuar ...” zëvendësohen me “... në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e territorit, peizazhit dhe pyjeve nga ndërhyrjet e kundërligjshme ...”.

c) Në pikën 5, fjalët “... rajonal përkatës ...” zëvendësohen me “... përkatës në bazë qarku ...”.

4. Në pikën 4, të kreut IV, fjalët “... me nenin 11, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, ‘Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme’” zëvendësohen me “... me dispozitat ligjore në fuqi.”.

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**